

**RENDI I DITËS**

*“Për shqyrtimin administrativ të denoncimit të Organizatës “Qëndresa Qytetare”,  
për ndalim të aktivitetit të kandidatit të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, zotit  
Albert Halilaj, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24  
shtator 2023”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

- Staf i KQZ: Z. Y. Merkaj, znj. I. Osmanaj, z. K. Puleri.

Parti Politike: S’ka prezent!

Të tjerë: KRIIK, Qëndresa Qytetare (z. Dh. Zguri, z. M. Qeraxhiu)

*Z. I. Celibashi:* Mirëdita, atëherë në këtë seancë kemi në shqyrtim denoncimin e bërë nga Organizata Qëndresa Qytetare në lidhje me një aktivitet elektoral dhe një koncert të planifikuar për t’u zhvilluar nga Partia Socialiste dhe nga kandidati për kryetar bashkie mbështetur nga kjo parti, në zgjedhjet për kryetar të Bashkisë së Kukësit. Janë prezent përfaqësuesit e Organizatës Qëndresa Qytetare. Ndërkohë kemi bërë njoftimet përkatëse dhe kemi komunikuar me përfaqësues të Partisë Socialiste dhe me kandidatin, në lidhje me këtë çështje në kuadër të seancës publike që do të zhvillojmë, të cilët kanë kthyer një përgjigje zyrtare sipas së cilës nuk di.. jua kemi kemi dhënë përfaqësuesve të Qëndresës? Sipas së cilës ata thonë që... pasi janë njohur, po në fakt e kemi bërë dhe këtë komunikim. Ju bëjmë me dije se Partia Socialiste dhe kandidati i saj zoti Albert Halilaj nuk organizon dhe nuk zhvillon sot

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 20.09.2023*

koncertin në qytetin e Kukësit. Tani në këtë situatë, unë mendoj që të vendosim, nëse përfaqësuesit e Qëndresës nuk kanë ndonjë gjë për të shtuar, pushimin e shqyrtimit administrativ dhe ndërkohë ne si institucion, KQZ-ja do të monitorojmë në lidhje me këtë çështje. Jemi dakord besoj?

**Z. Dhimitër Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare:** Po, mora kopjen e shkresës të kandidatit të Partisë Socialiste dhe të përfaqësuesit të Partisë Socialiste në KQZ. Më duket në fakt një përgjigje jo... as korrekte, po as e saktë se vetë kandidati e ka postuar në rrjetet sociale dhe pas momentit që është dërguar ky email. Email-i i parë nga zoti Eridian Salianji është dërguar në orën 15:05 minuta. Në orën 15:15 minuta postimi ka qenë ende aktiv në faqen e zotit Albert Halilaj dhe më pas zoti Albert Halilaj kujtohet dhe fshin postimin. Kështu që nuk më duket korrekte që zoti Albert Halilaj nuk do ta organizojë këtë koncert. Po edhe në kuptim të ligjit po t'i referohemi pikës 9, të nenit 78, “..subjektet zgjedhore e kanë të ndaluar të organizojnë koncerte qoftë edhe nëse nuk e organizojnë ata drejtpërdrejtë, po bëhet me burime të palëve të treta..”. Kështu që... mendoj se çështja duhet të vijojë sigurisht, duhet bërë një monitorim gjatë ditës së sotme. Qëndresa, por dhe monitoruesit e KQZ-së duhet të bëjnë monitorim nëse ky koncert do të mbahet. Do të sugjeroja që në rast se do të mbahet koncerti të mund të merren masa administrative ndaj subjektit zgjedhor, në bazë të nenit 171 të Kodit Zgjedhor.

**Z. I. Celibashi:** Plotësisht dakord me çfarë ju thoni, por këtu nuk është qëllimi që ne detyrimisht të vendosim sanksione për raste kur subjektet zgjedhore reflektojnë ndaj kërkesave për të përmbushur detyrimet e Kodit Zgjedhor. Në komunikimin që kemi pasur me përfaqësues të këtij subjekti zgjedhor, kanë konfirmuar që ky koncert i

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 20.09.2023*

Partisë Socialiste dhe i kandidatit nuk do të zhvillohet. E kemi kërkuar me shkrim këtë angazhim dhe e kanë sjellë me shkrim. Kështu që në këtë situatë mendoj unë ajo çfarë mbetet është të shohim se çfarë do të ndodhë. Ne nuk mund të ndalojmë një gjë të cilën ata thonë që ne nuk do ta bëjmë.

**Z. Dhimitër Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare:** Jam dakord me këtë pjesë, është thjesht..., ndoshta në interpretim të paktën, ekziston mundësia që do të interpretohet sipas kësaj mënyre, por unë kisha një interpretim tjetër që nuk organizohet personalisht nga këta dhe organizohet nga palë të treta, kështu që jam në rregull me atë çfarë thuhet.

**Z. I. Celibashi:** Ligji është shumë i qartë dhe duke qenë se ligji është shumë i qartë ua kemi bërë me dije këtë qartësi edhe palëve të interesuar në këtë proces, se natyrisht nuk kemi asnjë arsye që të rrimë dhe “po të kapa tani ty, do të sanksionoj”. Kjo është natyra e institucionit edhe e zhvillimit të procesit zgjedhor, nuk është si rasti i gjykatës të themi që t’i gjendesh para një fakti, të cilin ta ka bërë prezent njëra prej palëve dhe do të vendosësh. Në kuadër të miradministrimit të procesit zgjedhor dhe të respektimit të disa parimeve që lidhen me zhvillime të procesit zgjedhor, natyrshëm komunikon me palët për të gjetur atë zgjidhje që shkon në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor. Ndaj dhe këtë angazhim të tyre kërkuam që ta kishim me shkrim, kështu që besoj se arsyetimi i bërë nga ana jonë qëndron. Tani mbetet për t’u parë jo vetëm për këtë, po për çdo lloj aktiviteti tjetër që mund të zhvillojnë kandidatët atje. Është e qartë besoj, të paktën për ne, për ju po e po, por dhe për të tjerët, ndalimi i Kodit Zgjedhor për të organizuar koncerte, apo edhe aktivitete bamirësie, edhe aktivitete të tjera me natyrë elektorale si drejtpërdrejtë ashtu edhe

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt. 20.09.2023*

nga palë të treta, po për llogari të kandidatit apo të subjektit. Jemi të qartë? Dakord edhe me këtë?

**Z. Dhimitër Zguri, përfaqësues i Qëndresës Qytetare:** Po dakord!

**Z. I. Celibashi:** Mirë faleminderit, seanca mbyllet edhe ditë të mbarë!

**Vendimi nr. 783**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

